



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 40, datë 28.03.2024

**PËR
MIRATIMIN E TABELËS SË PRIMIT TË RREZIKUT PËR PËRLLOGARITJEN E
PROVIGJONEVE TEKNIKE PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË
PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK, PËR DËMET QË U
SHKAKTOHEN PALËVE TË TRETA NGA PËRDORIMI I KËTIJ MJETI, TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “INSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe pikës 22, të nenit 14, të ligjit 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e tabelës së primit të rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, për kontratat e sigurimit MTPL e brendshme (tabela bashkëlidhur këtij vendimi).**
- 2. Shoqëria publikon primet e rrezikut, si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara gjatë gjithë periudhës së zbatimit.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**

Tabela: Primet e rrezikut të shoqërisë “**Insig**” sh.a., për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete, për kontratat e sigurimit **MTPL** e brendshme:

Kateg.	Klasa	Tipi	Kapaciteti motorik(cm3)/ ose pesha mbajtëse (T)/ ose numri i vendeve	Tarifat e primit të rrezikut të përlllogaritura (në Lekë)
A 1		Motoçikleta	Kapaciteti motorik	
	A 1/1		Deri në 150 cm ³	3,000
	A 1/2		Mbi 150 cm ³	4,800
B 1		Autovetura	Kapaciteti motorik	
	B 1/1		Deri në 1600 cm ³	8,800
	B 1/2		Mbi 1600 cm ³	10,300
B 2		Furgonë, Mikrobuse	Numri i vendeve	
	B 2/1		Nga 5 deri në 8 vende	14,700
	B 2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	19,700
C 1		Autobuse	Numri i vendeve	
	C 1/1		Mbi 15 vende	31,800
D 1		Kamionçina	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 1/1		Deri në 3.5 ton	14,200
D 2		Kamionë	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 2/1		Mbi 3.5 ton	23,300
E 1		Rimorkio	Pesha mbajtëse (Ton)	6,500
F		Mjete bujqësore		5,200
G		Zjarrfikëse		12,800

*Tarifat e aplikuara për shitje mund të ndryshojnë ndjeshëm nga primi i rrezikut.